

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	VIDEO/ Kinemaja shqiptare ka gjetur rrugën për në Evropë. Po për te publiku i saj?
ADRESA	https://www.gazetatema.net/kulture/video-kinemaja-shqiptare-ka-gjetur-rrugen-per-ne-evro-pe-po-per-te-publik-i584189
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	redirected

KOHA


KAPUR NGA NE	5 shtator 2026, 18:50:37 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	6 shtator 2026, 15:00:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	322bc74c3aa467fa685095f4e0babef750926a9d1380dfa2d20b4c89cbcf6e48
TEKSTI	25fc7c1a74813a811b44fa54d9db61b88a2548e05a7e6cfe46da2f1d050ecc3a
PAMJA	9f057153817f44b5363fa5db80ed59069cbd03931cb089f11d24e6dc1c741002

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	1c4666d92c0cbbef1b092a990c59f8b735c7167b1abd036010bec693edc892b6
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	82597d84b51b00d12dc8da6bd19ef563dde476bcf2b8ac3fbaec8c83c315f326
ANKORUAR	Polygon PoS · bllok 46991200
TRANSAKSIONI	0x4a6949f734bb917e86ef48a394a39f5e560c6ca7cb50992564901c0d93c74ab3
IPFS	QmcQ2vpHEy67KT56kkLEBokuUFGqg7MP3SJ63znFCszpz



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/1c4666d92c0cbbef1b092a990c59f8b735c7167b1abd036010bec693edc892b6>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

 English

Built and Monetized by  [Kontakt](#)

 English

1 e [Brace shperthen ndaj piromaneve: Edhe te djegura, sipertaqet mbeten fond pyjor, nuk behen hotele e resorte](#)[Pagat e magistratave vryoje te mos ekzekutohen, reagojne fundit](#)

VIDEO/ Kinemaja shqiptare ka gjetur rrugën për në Evropë. Po për te publiku i saj?



6 Shtator 2026, 17:00Kulturë Bjorn Runa

Ka diçka të çuditshme në mënyrën si na mbërrijnë lajmet për filmin shqiptar. Dëgjojmë se një film është përzgjedhur në një festival ndërkombëtar, apo se ka fituar një çmim, por mes kënaqësisë që një kineast shqiptar po vlerësohet jashtë dhe mundësisë për ta parë vetë atë film, mund të kalojë shumë kohë. Ndonjëherë, lajmi për suksesin është i vetmi kontakt që kemi me veprën.

Gjatë bisedës me regjizorin Ilir Butka, drejtor artistik i Festivalit Kombëtar të Filmit Shqiptar, u ndalëm tek disa raste kur prodhime kinematografike shqiptare mjaft cilësore, të njohura e vlerësuara edhe ndërkombëtarisht, shpesh kanë një premierë të shkurtër në vendin tonë dhe të vetmet mundësi për t'i parë janë eventet kulturore, në vend që të kemi mundësi t'i gjejmë ato në kinema një fundjavë, siç ndodh për shembull me filmat e huaj, apo me filmat komercial.

Rikthimi i festivalit, pas një mungese 14 vjeçare, ishte arsyeja e kësaj bisede, por ndër të tjera, më interesonte edhe ajo që kjo mungesë ka lënë pas: një kinematografi vendase që vazhdon të prodhojë, por pa arritur të ndërtojë një marrëdhënie të qëndrueshme me spektatorin e saj.

"Ne arrijmë të financojmë prodhimin e filmit, por nuk e financojmë distribuimin e filmit."

Në pamje të parë, e gjitha tingëllon si një mangësi administrative. Në të vërtetë, shpjegon shumë më tepër. Një film mund të quhet i përfunduar për regjisorin, por jo për publikun. Duhet dikush që ta çojë në sallat e kinemasë dhe t'i japë një jetë përtej premierës, duke krijuar arsyet dhe mundësitë që njerëzit të shkojnë ta shohin. Sipas Butkës, pikërisht kjo hallkë profesionale, distributori, mungon në sistemin tonë, bashkë me mbështetjen që mund ta bënte të mundur.

"Një regjisor, në momentin që mbaron së krijuari një film, ka filluar në mënyrë të pavetëdijshme filmin tjetër në kokën e tij."

Kjo mënyrë e shpjegimit e largon bisedën nga kritika e zakonshme se artistët nuk dinë të promovohen. Regjisorit që mendon filmin e ardhshëm nuk po bën domosdoshmërisht diçka të gabuar. As producenti që kërkon financimin e projektit tjetër. Por, kur i njëjti rreth i vogël njerëzish duhet të shkruajë, të prodhojë dhe pastaj të gjejë edhe spektatorin, një pjesë e punës mbetet pa u bërë.

Këtu biseda mori një kthesë interesante. Butka nuk mendon se filmi autor nuk ka çfarë të mësojë nga filmat komercialë. Përkundrazi, edhe kur ka rezerva për nivelin e tyre artistik, ai u njehtëftëson që filmave të vlerësuar në festivale shpesh u mungon.

"Shpeshherë [filmat komercialë] janë produkte jo të nivelit të lartë, por janë brilante në aspektin e distribuimit dhe gjetjes së publikut."

Kjo nuk do të thotë se numri i biletave është matësi përfundimtar i cilësisë. Por as çmimi ndërkombëtar nuk e zgjidh vetvetiu çështjen e shikuesit. Një film mund t'i ketë merituar plotësisht vlerësimet dhe përsëri të mos ketë gjetur mënyrën për t'iu afruar publikut të vendit të vet. Pyetja është nëse këto dy përvoja mund të mësojnë nga njëra-tjetra, pa kërkuar që çdo film të bëhet i njëjtë.

Kur e pyeta se çfarë u mungon regjisorëve të sotëm shqiptarë, Butka nuk pranoi t'i fuste autorët në një kategori të vetme. Formimi, përvoja dhe këndvështrimi i secilit, tha ai, janë tepër të ndryshëm për t'u shpjeguar me një përgjigje të përgjithshme. Por ai identifikon një mungesë tjetër, që nuk ka të bëjë me talentin individual.

"Ne nuk jemi një komunitet që komunikojmë sa duhet me njëri-tjetrin."


Nuk mungon vetëm takimi me spektatorin, por edhe ballafaqimi mes kolegësh: aftësia për ta parë punën nga një kënd tjetër dhe për të mirëpritur një sugjerim. Kjo e zhvendos rolin e festivalit përtej shfaqjeve dhe ceremonive. Ai mund të jetë vendi ku një komunitet krijues rifillon një bisedë që, sipas Butkës, nuk e ka zhvilluar mjaftueshëm.

Megjithatë, Butka flet me optimizëm për bashkëprodhimet rajonale, për përvojën e producentëve, financimet evropiane dhe pajisjet që tashmë mund të gjenden në Shqipëri. Në një vend ku integrimi evropian zakonisht diskutohet si premtim për të ardhmen, ai e përshkruan kinemanë si një fushë ku bashkëpunimi tashmë funksionon.

“Kinematografia [shqiptare] është pjesë e Evropës nëpërmjet qenies pjesë në mekanizmat evropianë të financimit.”

Por rruga drejt partnerëve evropianë duket, në disa aspekte, më e shtruar sesa ajo drejt spektatorit shqiptar. Për Butkën, kjo është veçanërisht e dukshme te të rinjtë, të cilët, sipas tij, shpesh nuk njohin as filmat, as njerëzit që i realizojnë. Ndaj matësi i suksesit të festivalit që propozon është mjaft konkret: një sallë ku të paktën gjysma e publikut të jetë e re në moshë.

Në fund, biseda na ktheu te financimi, por tashmë nga ana tjetër. Nëse provohet se ka një publik që e kërkon filmin shqiptar, argumenti për ta mbështetur bëhet më i fortë. Financimi, siç thotë Butka, mund të trajtohet “jo si luks, por si një domosdoshmëri”.



Transkripti i plotë

Bjorn Runa: Festivali Kombëtar i Filmit Shqiptar rikthehet pas katërmëdhjetë vitesh mungesë. Do të zgjasë dhjetë ditë dhe bën bashkë një dekadë e gjysmë filma shqiptarë dhe disa gjenerata kineastësh që kanë formësuar kinemanë shqiptare. Çfarë pritet të sjellë ky edicion i Festivalit Kombëtar të Filmit Shqiptar dhe çfarë e bën të veçantë rikthimin e tij pas një kohe kaq të gjatë?

Ilir Butka: Përpos numrit të filmave që gjatë këtyre katërmëdhjetë viteve janë akumuluar ndërkohë dhe janë parë nga publiku shqiptar, sepse premierat e tyre janë bërë, por nuk kanë pasur ndoshta mundësi të distribuohen në një sistem të zgjeruar, të vërtetë distribuimi në kinematë tona, jepet një shans i mirë që të bëjmë një reflektim mbi këta filma të prodhuar ndër vite dhe të kuptojmë realisht se cili është raporti që kemi lënë pa konsumuar me shikuesin. Janë filma që, pavarësisht se ka vite që janë prodhuar — ka edhe filma të viteve të fundit — nuk mund të themi me plot gojën që e kanë ezauruar kontaktin e tyre me shikuesin. Vështirësitë e distribuimit, që tashmë i dimë, lidhen me një sërë arsyesh. Lidhen me faktin që ne, në sistemin tonë të prodhimit të filmit, në Qendrën Kombëtare të Kinematografisë, nuk e kemi konsideruar distribuimin si një hallkë të rëndësishme, referuar faktit që nuk është financuar. Ne arrijmë të financojmë prodhimin e filmit, por nuk e financojmë distribuimin e filmit. Kjo nënkupton një sërë elementesh që kanë të bëjnë me distribuimin: promovimin në radhë të parë, realizimin e siglave dhe të trailerëve promovues. Pra, na mungon një sistem i tërë promovimi dhe, nëpërmjet festivalit, mendojmë se këtë hallkë të munguar të sistemit mund ta anashkalojmë dhe të tentojmë të vendosim një lidhje direkte me spektatorin, me publikun, në mënyrë që të shikojmë ku jemi me filmat që kemi realizuar, por edhe për të kuptuar pak më shumë lidhur me kërkesat që ky spektator ka. Duke mos pasur këtë lloj kontakti me spektatorin, ndoshta kemi humbur një lloj ndjeshmërie ndaj pritshmërive të tij. Dhe, sigurisht, vendosja e këtij kontakti nënkupton që duhet të marrim në konsideratë çfarë shikuesi pret nga ne. Kemi filma të realizuar katërmëdhjetë vjet më parë, por ka edhe filma të fundit, të cilët kanë një diferencë të madhe teknike midis tyre, kanë diferenca tematike shpeshherë, por kanë edhe diferenca në aspektin konceptual. Ka filma që tingëllojnë tepër të rinj dhe, si të tillë, kanë vajtur në festivale ndërkombëtare të rëndësishme, kanë fituar shumë çmime. Është edhe ky një fakt që tregon, në njëfarë mënyre, cilësinë e tyre. Ne kemi një certifikatë garancie për cilësinë e këtyre filmave. Në asnjë nga festivalet ndërkombëtare nuk të hapet dera lehtësisht për të konkurruar, pikë së pari për të marrë pjesë. Pastaj, mos flasim për të fituar çmime. Do të thotë që këto çmime i kanë merituar, sepse ne nuk kemi mundësi të krijojmë një lloj presioni, qoftë ndaj jurive, qoftë ndaj vetë selektorëve të festivaleve, për të na marrë filmat tanë dhe për t'i vlerësuar. Kjo do të thotë që filmat atje kanë funksionuar, janë pëlqyer. Duhet të ngremë pyetjen përse kjo pëlqyeshmëri nuk është edhe në ambientin tonë. Ndoshta nuk e kemi kryer mjaftueshëm fazën e promovimit dhe pikërisht këtu jemi përqendruar në këtë festival. Kemi ngritur një sistem të vërtetë promovimi të autorëve të festivalit, duke u dhënë zë atyre. Kemi marrë intervista, kemi realizuar, në thonjëza, disa podkaste me ta, duke menduar se ndoshta kjo ka qenë edhe arsyeja që këta personazhe, këta krijues, nuk kanë arritur dot të promovojnë vetveten dhe, si pasojë, edhe produktin e tyre. Duke u përpjekur ta kompensojmë këtë mungesë nëpërmjet këtyre podkasteve, kemi parë me vëmendje edhe një politikë të promovimit të tyre në rrjetet sociale. Pra, festivali në vetvete ka qenë, në këtë rast, një strategji e mirëfilltë për promovimin e festivalit dhe të filmave të këtyre njerëzve, duke filluar që nga edicionet e kaluara të festivalit. Duke i dhënë publikut një informacion paraprak se çfarë është ky festival, çfarë është kinematografia shqiptare në përgjithësi, si kemi arritur deri këtu dhe pastaj duke u marrë një më një me të gjithë këta krijues që kanë një trajektore të tyre personale nëpër festivale, nëpër aktivitete të ndryshme ku kanë marrë pjesë, për të dhënë edhe zërin e tyre: çfarë mendojnë rreth argumenteve të rëndësishme që kanë të bëjnë me kinematografinë, me jetën sociale, me shikuesin, me bashkëprodhimet me vende të tjera, me financimet. Besoj që kjo strategji, kjo mënyrë të pari të promovimit të krijuesve dhe të festivalit në vetvete, do të sjellë të paktën një interes te publiku. Duam që publiku të kthejë kokën. Ajo që synojmë shumë këtë vit dhe këtë edicion është edhe mosha e këtij publiku. Do të donim shumë që të ishte një publik i ri, një moshë e re

sepse kemi konstatuar me keqardhje që, nga një pjesë e madhe e rinisë shqiptare, nuk njihet fare kinematografia e këtij vendi. Kur flas për kinematografinë, flas për regjisorët, për kineastët në përgjithësi, por flas edhe për aktorët. Aktorët në të gjithë kinematografinë e botës janë yje që janë subjekt frymëzimi për rininë. Këtu nuk ekziston kjo tendencë për të konsideruar një aktor si një imazh të adhuruar të rinisë shqiptare. Sigurisht, kanë aktorë të huaj, por kjo i ka larguar shumë nga një marrëdhënie me një produkt vendas dhe me një masë njerëzish vendas që krijojnë këtë produkt që quhet kinematografi. Të përpiqemi të kuptojmë ku kemi gabuar dhe ta kompensojmë këtë gabim, duke propozuar një realitet që ekziston në fakt; nuk po e krijojmë. Nuk jemi duke krijuar një realitet. Është një realitet që po përpiqemi ta shpluhurosim, ta propozojmë, ta ripropozojmë në një imazh të ri, në një formë të re, me synimin për të ngjallur këtë lloj marrëdhënieje. Do të ishte sukses i vërtetë nëse, pikë së pari për kuriozitet, të rinjtë shqiptarë të vinin në sallë. Shikoni filma shqiptarë, sepse, me thënë të drejtën, ka shumë filma interesantë, si të filmi i gjatë, ashtu edhe të filmi i shkurtër, që janë më pak impenjativë, që i bëjnë bashkëmoshatarët e tyre. Në njëfarë mënyre, të jenë kuriozë për të parë çfarë prodhojnë këta njerëz. Ka filma dokumentarë, ka filma të animuar. Është një ofertë ndaj së cilës vështirë mund të qëndrosh indiferent. Shpresoj që kjo të mos ndodhë.

Kam dy pyetje që po i bëj bashkë, sepse lidhen edhe me këtë që po thoshit. E para lidhet me mungesën: pse u deshën kaq shumë vite që festivali të rikthehej dhe çfarë e bëri të mundur rikthimin e tij pikërisht tani? Dhe e dyta: çfarë tregon kjo mungesë kaq e gjatë për vendin që zë kinemaja në prioritetet kulturore të Shqipërisë, të vendit ku jetojmë?

Arsyeja pse është vonuar kaq shumë... Të kërkojsh një arsye është pak e vështirë. Duhet të jenë disa arsye. Një nga arsyet mund të jetë fakti që, në edicionet e fundit, erdhi duke u larguar një edicion nga tjetri. Filloi të organizohej një herë në tre vjet, një herë në katër vjet, një herë në pesë vjet. Pra, fillonte të largohej, patjetër për shkak të mungesës së prodhimeve të mjaftueshme. Ishin prodhuar pak filma dhe kjo nuk lejonte që të organizonim më shpesh festivalin. Por, duke iu referuar viteve kur unë kam qenë kryetar i Qendrës, synimi ka qenë të rritet numri i prodhimeve të kinematografisë dhe realisht numri u rrit. Kur unë mendoja që ndoshta pas pesë vjetësh mund ta organizoja, që ishte një kohë e mjaftueshme për të organizuar një festival, unë nuk u riemërova. Kështu që i kaloi një kryetari tjetër kjo detyrë, që ndoshta nuk e kishte prioritet, sepse ka pasur prioritet prodhimin. Përgjithësisht kemi qenë shumë të përqendruar te prodhimi, te sasia dhe cilësia e prodhimit, duke anashkaluar pikërisht këtë hallkë, duke mos e menduar — dhe kalojmë te pyetja e dytë — si një hallkë të domosdoshme, jetësore, për të realizuar edhe atë të parën. Nuk ka rritje të prodhimit pa pasur edhe një reflektim të vazhdueshëm rreth atij prodhimi që ke realizuar. Dhe, përsëri duke iu referuar pyetjes së dytë, për të parë se sa shoqëria shqiptare mund të lidhet me këtë lloj prodhimi: a është e interesuar vërtet? Flas për shoqërinë, por edhe për politikën, në të gjitha aspektet. A e shikojmë në një prodhim kinematografik si pjesë të pandarë të zhvillimit të këtij vendi? Mendoj që artet në përgjithësi duhet ta kenë këtë lloj prirjeje. Duhet të shkojnë krah për krah me rritjen ekonomike, financiare, në të gjitha aspektet. Ndoshta ne, duke vepruar në këtë mënyrë, duke mos i dhënë vendin që meriton një festivali, që në fund të fundit është një festë e madhe dhe një demonstrim i asaj çka jemi në gjendje të prodhojmë, ia kemi hequr të drejtën vetes me këtë mungesë, pa e kuptuar, duke mos e bërë të domosdoshme atë që shoqëria duhet të ndiejë rreth detyrimeve që ka ndaj këtij arti, ndaj kësaj fushe, ndaj kësaj gjinie në kompleksin e kulturës. Besoj që me këtë festival do të përpiqemi ta kompensojmë këtë vakuum të krijuar dhe ndoshta nuk do ta tolerojmë më këtë zgjatje në kohë të riprezantimit të prodhimeve. Shpresoj që të mos përsëritet kjo gjë.

Ju, në fakt, iu përgjigjët edhe pyetjes së radhës që kam, por do të doja ta shpjegojmë në mënyrë pak më të hollësishme. Ne kemi prodhime dhe kemi prodhime goxha të mira filmike, që kanë pasur suksese në festivale dhe janë pritur mirë. Megjithatë, duket sikur pas momentit të suksesit në festival ndodh një lloj thyerjeje në sistem. Filmat prodhohen, financohen, konkurrojnë jashtë dhe pastaj sikur zhduken ose kanë një jetë shumë të shkurtër në kinema në Shqipëri. Po marr si shembull, vetëm sepse e pëlqej — është subjektive, e pëlqej si regjisor dhe e kam pasur të ftuar edhe në podcast — Gentian Koçin, për filmin “Një filxhan kafe dhe këpucë të reja veshur”. Është një film fantastik, që më preku vërtet kur e pashë, dhe mundësia që pata ta shikoja pas premierës ishte në një nga këto aktivitetet tek Art Explora. Më ka ndodhur edhe me filma të tjerë shqiptarë që sikur nuk qëndrojnë shumë gjatë në kinema private ose në kinema të zakonshme, ku njerëzit shkojnë në fundjavë. Nuk shkojnë thjesht për të marrë pjesë në një aktivitet kulturor, por edhe thjesht për të parë një film, për të kaluar ca momente të fundjavës.

Ka një kontradiktë të madhe, në fakt, për mendimin tim, rreth qëndrimit që një regjisor dhe një producent kanë ndaj një filmi të realizuar. Sepse një regjisor, në momentin që mbaron së krijuari një film, ka filluar në mënyrë të pavetëdijshme filmin tjetër në kokën e tij. Pra, ka filluar të investojë për filmin tjetër. Dhe vështirë do të gesh një regjisor që të jetë shumë i devotshëm në distribuimin, në shpërndarjen, në kujdesin që duhet të tregojë për filmin e kaluar. Ai ka filluar të operojë në një tjetër sistem, ndërkohë që producenti, duke qenë se është i lidhur me pjesën financiare të filmit, përpiket të nxjerrë nga ky film i sapombaruar të ardhurat e tij. Pra, ka një kontradiktë brenda një qenieje që mund të jetë edhe regjisor, edhe producent njëkohësisht. Aq më tepër po të shtojmë faktin që në të gjithë botën është gjetur një zgjidhje e tretë që quhet distributor. Një person tjetër, një menaxher i distribuimit, e merr filmin dhe kujdeset ai praktikisht. Pra, e lë edhe vetë producentin të lirë të operojë me filmin e ardhshëm. Është një specialist që fillon të investohet për ta shtrydhur këtë produkt dhe për të nxjerrë lëngun e duhur, për të siguruar të ardhurat për filmin tjetër. Duke mos e pasur këtë hallkë, këtë të tretin, distributorin, ne ia delegojmë përsëri këtyre dy faktorëve, regjisorit dhe producentit, duke e zvarritur projektin e radhës të tyre dhe duke u kthyer në pengesë për ta, në thonjëza. Edhe u pëlqen të merren me të, ta distribuojnë dhe ta shpërndajnë, por thellë-thellë nuk është misioni i tyre. Misioni i tyre ka mbaruar tashmë. Ata kanë dorëzuar produktin dhe duhet të sjellin produktin e radhës. Në një botë frenetike, normalisht ata duhet të kishin bërë këtë gjë, duhet të kishin parë produktin e radhës. Në botën ku jemi është e pamundur t'i bësh të dyja njëkohësisht, sepse kërkon shumë energji. Do të thotë të kërkojsh financimin e ri të projektit të radhës. Atëherë, kush është ai që do ta kryejë këtë funksion? Është një hallkë e munguar, nuk e kemi, nuk ekziston në sistemin tonë. Aq më keq, jo vetëm që nuk e kemi, por nuk ekzistojnë as stimuj, nuk kemi as mbështetje financiare. Nuk është parashikuar për një kategori që mund ta krijojmë. Por, duke mos pasur asnjë mbështetje financiare nga shteti, mbetet totalisht inert dhe i painteresuar kushdo që mund ta ketë vokacion këtë gjë. Këtë pjesë e bëjnë shumë mirë, çuditërisht, filmat komercialë. Filmat komercialë shkëlqejnë në kjo pjesë, jo te pjesa e parë e prodhimit. Shpeshherë janë produkte jo të nivelit të lartë, por që janë brilante në aspektin e distribuimit dhe gjetjes së publikut. Kurioziteti është si mund të gjejmë mekanizma të përbashkët bashkëpunimi, që të marrim nga filmat komercialë distribuimin dhe ata të marrin nga filmat autorialë, nga filmat e nivelit të mirë, disa karakteristika që do t'u jepnin vlerë atyre. Vlerë në aspektin artistik. Është një çështje që nuk e kemi zgjidhur akoma dhe nuk e di si mund ta kenë zgjidhur edhe të tjerët. Janë dy gjëra që ecin paralel dhe nuk prekin asnjëherë njëra-tjetrën. Njëra nxjerr lekët nga një produkt që nuk është shumë i mirë artistikisht. Tjetra është produkt i mirë artistikisht, çan festivale me çmime, vlerësohet, por nuk e gjen dot publikun. Kjo gjë duhet gjetur. Ndoshta vetë Qendra Kombëtare e Kinematografisë duhet të gjejë një sistem që nxit këtë lloj qasjeje të publikut me produktin që ajo financon që në fillim të herës, që është produkt kinematografik autorial.

Festivali, siç e thatë edhe ju, ka filma të një dekade e gjysmë, por ka edhe filma të kohëve të fundit. Jam kurioz: kur shihni punën e regjisorëve të rinj shqiptarë sot, ose jo domosdoshmërisht regjisorë të rinj, por filma të rinj, prodhime të reja, çfarë mendoni se u mungon më shumë? Ka një element, një faktor ose një tipar që shfaqet si mungesë më shpesh te shumica e tyre?

Nuk do ta thosha. Janë kaq të ndryshëm nga njëri-tjetri, saqë do të ishte e vështirë të përgjigjeshe me një sugjerim. Secili ka gjetur rrugën e tij në bazë të formimit kulturor që ka, në bazë të njohive lidhur me fushën e kinematografisë, në bazë të përvojave personale, në bazë të shkollës që ka ndjekur. Kemi njerëz

një rrezë të mirë të prodhimit vendas dhe të gjergjes së sistemit, jo vetëm material, por edhe të pajisjeve teknike. Në kemi edhe me urdhë status që emigrojnë pajisje me qira. Nuk ka nevojë më të merret asnjë pajisje nga jashtë. Janë të gjitha të financuara në Shqipëri. Kemi një realitet kinematografik shumë pozitiv për sa i përket anës teknike, që ka qenë pika e dobët; nuk e kemi më këtë gjë. Besoj që jemi në një moment fatlum, të cilin duhet ta shfrytëzojmë pozitivisht, duke zgjidhur pikë së pari raportin me shikuesin shqiptar. Nëse zgjidhim raportin me shikuesin, do të ushtrojmë realisht një presion serioz ndaj politikës që ta konsiderojë financimin e filmit si një hallkë të domosdoshme të plotësimit të raportit me një audiencë që e kërkon filmin. Pra, po e vërtetuar që audiencia shqiptare do film shqiptar, besoj se do të kemi të gjitha argumentet e duhura për të bindur çdo lloj qeverie që ta konsiderojë financimin e filmit jo një luks, por një domosdoshmëri. Aq më tepër që ne e kemi vërtetuar se çdo euro e hedhur në kinematografi sot është e barabartë me pesë euro të rikuperuara nga ne nga financimet evropiane. E kemi rentabël, hajde ta bëjmë edhe të pëlqyeshme nga publiku.

Nëse mund ta kujtojmë edhe një herë për ata që do ta shohin këtë intervistë: ku mund të vijnë t'i shohin filmat dhe ku mund ta ndjekin festivalin?

Kemi katër salla në dispozicion. Salla e parë është salla e Akademisë së Arteve, salla e koncerteve, që është një sallë e madhe. Është zgjedhur e para për marrëdhënien që ka pasur gjithmonë me artistët dhe me të gjithë ata që kanë mbaruar Shkollën e Arteve. Pjesa dërmuese e regjisorëve të vjetër, por edhe një pjesë e të rinjve, e kanë mbaruar këtë shkollë. Është një sallë me gjashtëqind vende. Ndoshta është salla më e madhe që kemi për kinemanë, nëse ajo është përshtatur për kinemanë. Nuk është sallë kinemaje, por është kërkuar pikërisht të ishte si e tillë, që të kishte sa më shumë mundësi mikpritjeje për njerëzit që

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.